



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETVE

Nr. 5264 Prot

Himarë, më 17.07.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim mbi trajtimin rekomandimeve të Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore) për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, Faza I.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Sekretarit të këshillit Z. Zaho Dedi

✓

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor” i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, VKB nr.32 datë 30.06.2026 “Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026” VKB nr.33 date 30.06.2026 “Per miratimin e fazes se pare te pergatitjes te programit buxhetor afatmesem 2027-2029, po ju dërgojmë relacionin dhe projektvendimin “Per shqyrtim dhe miratim mbi trajtimin rekomandimeve të Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore) për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, Faza I.

Faleminderit për bashkëpunimin.

K R Y E T A R

Vangjel Tavo

ME URDHËR DHE DELEGIM

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETVE

Nr. 5264 / Prot

Himarë, më 17.07.2026

PROJEKTVENDIM
NR. 47 DATË. 17.07./2026

“PER SHQYRTIM DHE MIRATIM MBI TRAJTIMIN REKOMANDIMEVE TË MINISTRISË SË FINANCVE (DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT, DREJTORIA E FINANCVE VENDORE) PËR PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2027–2029, FAZA I”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor” i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, VKB nr.32 datë 30.06.2026 “Për miratimin e disa ndryshimeve buxhetore mbi buxhetin e vitit 2026” VKB nr.33 date 30.06.2026 “Per miratimin e fazes se pare te pergatitjes te programit buxhetor afatmesem 2027-2029, po ju dërgojmë relacionin dhe projektvendimin “Per shqyrtim dhe miratim mbi trajtimin rekomandimeve të Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore) për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, Faza I.

VENDOSI:

1. Të miratohen rekomandimet dhe reflektimet ne relacion te Ministrise se Financave per fazen e pare te PBA 2027-2029.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Vangjel Tavo

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSKRYETARI
Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 5264/Prot
12

Himarë, më 17.07/2026

RELACION

Mbi trajtimin rekomandimeve të Ministrisë së Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Financave Vendore) për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, Faza I

Në vijim të analizës së kryer nga Ministria e Financave mbi Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029 të Bashkisë Himarë, dorëzuar në Fazën I, paraqiten më poshtë shpjegimet dhe argumentimet përkatëse për zërat e evidentuar si të nevojshëm për sqarim, në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 7, datë 27.02.2026 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027–2029".

1. Taksa e Përkohshme – Qëllimi dhe Periudha e Aplikimit

Taksa e përkohshme është vendosur nga Bashkia Himarë në zbatim të kompetencave të njësisë së vetëqeverisjes vendore për financimin e nevojave specifike, të lidhura kryesisht me aktivitete dhe shërbime sezonale që lidhen me rritjen e fluksit turistik gjatë periudhës verore. Aplikimi i saj shtrihet në periudhën kohore korrespondente me sezonin turistik dhe intensitetin e aktiviteteve ekonomike të përkohshme në territorin e bashkisë.

Në vijim të vërejtjes së Ministrisë së Financave, gjatë Fazës II të PBA-së, parashikimi i kësaj takse është korrigjuar dhe do të qëndrojë në të njëjtën vlerë për të gjithë periudhën 2027–2029, pa rritje progresive nga viti në vit, në përputhje me parimin e planifikimit të kujdesshëm dhe realist të kësaj kategorie të ardhurash, e cila nga natyra e saj ka karakter të përkohshëm dhe të kufizuar në aplikim.

2. Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë

Rritja e parashikuar prej +42.9% për vitin 2027 (nga 4,899,500 mijë lekë në 7,000,000 mijë lekë) mbështetet në planin e ardhur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT), i hartuar bazuar në kërkesat e paraqitura dhe në zbardhjen e vendimeve të lejeve të ndërtimit. Ky parashikim reflekton volumin konkret të lejeve në proces zbardhjeje pranë DPZHT-së, si dhe tendencën e zhvillimeve të reja në zonat me potencial turistik dhe banesor.

Bashkia Himarë merr në konsideratë vërejtjen e Ministrisë së Financave lidhur me faktin se e ardhura faktike e realizuar për vitin 2025 nga kjo taksë (rreth 1.8 miliardë lekë, sipas të dhënave të sistemit SIFQ) rezultojnë ndjeshëm më e ulët se parashikimet e periudhës PBA. Në këtë kuadër, gjatë Fazës II të PBA-së, ky zë do t'i nënshtrohet një rishikimi më realist, bazuar në të dhënat konkrete të DPZHT-së mbi numrin aktual të lejeve të

ndërtimit të zbardhura/në proces, me qëllim garantimin e realizueshmërisë dhe qëndrueshmërisë financiare të parashikimit.

3. Taksa e Pasurisë

Rritja e konsiderueshme e parashikuar për vitin 2027 (+75%, nga 90,500 në 158,700 mijë lekë) lidhet kryesisht me komponentin e taksës mbi transaksionet e pasurive të paluajtshme, i cili paraqet rritje edhe më të theksuar (+218%, nga 30,000 në 95,350 mijë lekë). Kjo prirje shpjegohet me faktin se Bashkia Himarë ndodhet aktualisht në një fazë intensive zhvillimi të territorit, çka sjell rritje të vazhdueshme të numrit dhe vlerës së transaksioneve të pasurive të paluajtshme, si dhe të pasurive të reja që hyjnë në regjistrim, veçanërisht në segmentin me destinacion turistik.

Bashkia Himarë angazhohet që në Fazën II të PBA-së të paraqesë një argumentim më të detajuar mbi bazën e këtij parashikimi, duke reflektuar të dhëna konkrete mbi volumin e transaksioneve të regjistruara dhe tendencën e tregut vendor të pasurive të paluajtshme, në përputhje me fazën e zhvillimit territorial në të cilën ndodhet bashkia.

4. Shpenzimet Kapitale

Struktura e shpenzimeve të Bashkisë Himarë karakterizohet nga një dominim i theksuar i shpenzimeve kapitale, të cilat përbëjnë rreth 78% të totalit të buxhetit në vitin 2027, me rritje graduale në 78.7% (2028) dhe 80.6% (2029). Kjo strukturë pasqyron orientimin strategjik të bashkisë drejt investimeve në infrastrukturë dhe projekte zhvillimore, në përputhje me profilin turistik dhe potencialin zhvillues të territorit.

Rritja e vlerës absolute të shpenzimeve kapitale (nga 7,535,520 mijë lekë në 2027 në 9,072,530 mijë lekë në 2029) shpjegohet kryesisht me rritjen e numrit të projekteve të investimeve, tendencë e reflektuar tashmë edhe në buxhetin e vitit 2026, si dhe në parashikimin e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Duke marrë parasysh vërejtjen e Ministrisë lidhur me realizueshmërinë e këtij zëri të të ardhurave, bashkia do të kryejë në Fazën II një rishikim të programimit të projekteve kapitale në përputhje me parashikimet e rishikuara të burimeve financuese.

5. Plani i Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura

Bashkia Himarë ka raportuar stokun e detyrimeve të prapambetura ekzistuese për vitin 2026. Në vijim të vërejtjes së Ministrisë së Financave, gjatë Fazës II të PBA-së këto detyrime do t'i nënshtrohen një filtri të ri vlerësimi dhe shpërndarjeje, me synim hartimin e një plani sa më realist dhe të qëndrueshëm financiarisht.

Sqarojmë se detyrimet e prapambetura të evidentuara nuk përfaqësojnë thjesht fatura të papaguara, por vlerat e mbetura të kontratave, duke përfshirë edhe të gjitha projektet e prokuruar dhe të regjistruara deri në muajin dhjetor 2025, kontratat e të cilave pritet të lidhen përgjatë vitit 2026. Kjo natyrë e detyrimeve, si dhe fakti që dokumentacioni plotësues mungon pjesërisht për një pjesë të tyre, ndikon në kompleksitetin e procesit të vlerësimit dhe kërkon kohë shtesë për verifikimin e plotë të tyre.

Fokusi i bashkisë gjatë periudhës së PBA-së do të jetë shlyerja e mbi 50% të detyrimeve të prapambetura, objektiv i cili do të konkretizohet në plan të detajuar me shpërndarje sipas viteve 2027, 2028 dhe 2029, në përputhje me kapacitetet financiare aktuale dhe me kompletimin progresiv të dokumentacionit plotësues të

nevojshëm. Ky plan synon minimizimin e riskut të bartjes së këtyre detyrimeve në periudhat e ardhshme buxhetore dhe garantimin e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë të bashkisë.

6. Numri i Punonjësve

Në vijim të kërkesës së Ministrisë së Financave, sqarojmë se numri total i punonjësve në nivel Njësie të Vetëqeverisjes Vëndore për Bashkinë Himarë është 333 (treqind e tridhjetë e tre) punonjës. Ky informacion do të reflektohet dhe plotësohet në sistemin SMBV, në mënyrë që struktura organizative e paraqitur të jetë e plotë dhe në përputhje me kërkesat e udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së.

Përfundime

Bashkia Himarë vlerëson vërejtjet dhe rekomandimet e paraqitura nga Ministria e Financave dhe angazhohet që në Fazën II të PBA-së 2027–2029 t'i reflektojë ato plotësisht, përfshirë raportimin e të dhënave historike të munguara, rishikimin e parashikimeve të të ardhurave në përputhje me realizimin faktik, riklasifikimin e zërave të investimeve, korrigjimin e produkteve sipas Shtojcës 4 të udhëzimit nr. 7/2026, si dhe plotësimin e informacionit mbi detyrimet e prapambetura dhe numrin e punonjësve.

DREJTORI I F.P.B.M.A

Besa Xhaferi

